



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br Prot. Prot No.
Nr. ftaq Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
DPK	03-02/2902/
02	29-09-2017
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.09.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2395/17, për z. Nusret Bushi, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Lokale N.Sh "Pastërtia" – Hani i Elezit, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Nusret Bushi, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Lokale N.Sh "Pastërtia" – Hani i Elezit, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në bizneset private N.T.Sh "Blini" dhe N.Sh "Pastërtia", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës z. Bushi është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, ka premtuar se brenda afatit ligjorë do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu larguar nga funksioni menaxherial në biznes privat.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresat zyrtare (DPKI-01-2773/17)(DPKI-01-2774/17), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë publik është larguar nga funksioni menaxherial në bizneset private të cituara më lartë. Me këtë rast është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

